V E N D I M
Nr. 560, datë 26.8.1996

PËR DHËNIE LEJE PËR FUNKSIONIMIN E INSTITUCIONEVE ARSIMORE PRIVATE

(Ndryshuar me VKM nr. 750, datë 23.9.2020; nr. 614, datë 22.9.2022)

(i përditësuar)

Në zbatim të nenit 44 dhe 65 të ligjit nr. 7952, datë 21.6.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar", me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të miratojë lejen për funksionimin e institucioneve arsimore private, si më poshtë:

a) Shkolla "Gjerasim Qiriazi" e nivelit të arsimit 8-vjeçar në qytetin e Tiranës. Ky institucion do të frekuentohet vetëm nga nxënës të huaj.

b) Kolegji turk "Turgut Ozal" i nivelit të arsimit 8-vjeçar.

c) Kolegji "Preka" i nivelit të arsimit të mesëm në qytetin e Korçës.

ç) Shkolla "Pjetër Mëshkalla" e nivelit të arsimit të mesëm në qytetin e Shkodrës.

d) Medresetë:

1. "Mahmud Dashi"Tiranë
2. *Shfuqizuar.*
3. "Liria"Cërrik
4. "Hoxha Tahsin"Gjirokastër
5. "H.Sheh Shamija"Shkodër

2. Për medresetë e mëposhtme të miratojë lejen për funksionimin e tyre vetëm me nxënësit që janë regjistruar në to para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7952, datë 21.6.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar" dhe deri në përfundimin e studimeve të këtyre nxënësve.

1. "Mustafa Varoshi"Durrës
2. "Vexhi Buharaja"Berat
3. "Sulejman Laçi"Kukës
4. "Raif Kadiu"Peshkopi
5. "Medreseja e Korçës"Korçë

3. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Sporteve të kontrollojë procesin mësimor laik dhe zbatimin e ligjshmërisë në fushën arsimore të këtyre institucioneve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi